L I G J
Nr.9189, datë 12.2.2004

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË LIGJIN NR.8378, DATË 22.7.1998 "KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8738, DATË 12.2.2001

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8738, datë 12.2.2001, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 121 pika 5 hiqen fjalët "para vitit 1974".

Neni 2

Në nenin 187, në fund të pikës 1 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
"Kursi i ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti kryhet nga Kryqi i Kuq Shqiptar në bashkëpunim me autoshkollën, sipas tarifave të miratuara nga Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, si dhe Ministria e Shëndetësisë".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4166, datë 2.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu